



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
SENATI

Nr. 4456 / prot
11

Shkodër me 22/01/2020

V E N D I M

Nr. 218 / datë 22.01.2020
11

“PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E STUDIMEVE TË USH”

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 38, pika 1/d, Statutit të Ush-së të miratuar 2018, neni 17, pika 6/r, Rregullores së studimeve të USH të miratuar me Vendimin e SA ne,182 date 28.5.2019, bazuar në kërkesat e disa departamenteve, Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në mbledhjen e tij të datës 22.01.2020

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 2 të nenit 15 “Leje për mungesa të planifikuara” si më poshtë:
“Leja për mungesa të planifikuara studimore duhet të jetë për një periudhë të caktuar kohe, e cila nuk duhet të jetë më pak se një semestër. Në këtë rast Sekretaria mësimore shënon në sistem ‘Pezullim’.
2. Ndryshimin e pikës 1 të nenit 20 “Transferimet” si më poshtë:
“USH pranon nga Universitetet e tjera dhe nga brenda USH-së transferime studentësh në vite të ndërmjetme në programe studimi të njëjta ose të ngjashme të të njëjtit sistem studimi, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore”.
3. Ndryshimin e nenit 26 “Vlerësimi i studentëve në lëndët me ‘Module’” si më poshtë:
*“Provimet për modulet që zhvillohen paralelisht, do të jepen në të njëjtën ditë në sezonin e provimeve në fund të semestrit përkatës”
Kur modulet me shtrirje vjetore të lëndës janë të njëpasnjëshme për çdo semestër, provimet jepen në sezonin e provimeve në fund të semestrit përkatës.
Kur modulet janë të njëpasnjëshme brenda një semestri, provimet jepen menjëherë sapo të mbarojë moduli.”*
4. Ndryshimin e nenit 27 pika 1 dhe 2 që zgjerohen si më poshtë
 1. Studentët e rregullt të çdo kursi regjistrohen në provim nga sekretaria mësimore. Pedagogët duhet të çojnë në SM listën e studentëve që për shkak të mungesave nuk futen në provim.

2. *Studentët përsëritës të vitit parë dhe vitit të dytë regjistrohen në provimet e kursit nga sekretaria mësimore.*
 3. *Studentët përsëritës që kanë përfunduar vitin e tretë regjistrohen individualisht për pjesëmarrje në provim.*
 4. *Regjistrimi i studentëve të përmendur në pikën 2 dhe 3 bëhet pasi ato kanë shlyer detyrimet financiare.*
- Pika 3 dhe 4 e nenit 27 kalojnë përkatësisht në pikën 5 dhe 6 të nenit 27
5. Ndryshimin e pikës 1 të nenit 31 “Sezonet e zhvillimit të provimeve të kursit” si me poshtë:

“Provimet në USH organizohen në dy sezone:

Sezoni i parë: *Pas përfundimit të procesit mësimor të semestrit të parë organizohet provim për të gjitha disiplinat e zhvilluara në këtë semestër, që në planin mësimor janë shënuar si provime.*

Sezoni i dytë: *Pas përfundimit të procesit mësimor të semestrit të dytë organizohet provim për të gjitha disiplinat e këtij semestri, që në planin mësimor janë shënuar si provime.*

Në këto sezona provohen studentët e rregullt dhe stazhierë të çdo kursi.”
 6. Ndryshimin e pikës 1 dhe 2 të nenit 32 “Përmirësimi i notes” si më poshtë:

“1. Studenti ka të drejtë të përmirësojë jo më shumë se dy disiplina të zhvilluara vetëm në atë vit akademik. Për këtë studenti duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore përkatëse, duke përcaktuar saktë disiplinat për të cilat dëshiron të riprovohet për t’i përmirësuar. Sekretaria mësimore bën regjistrimin e studentit në provim duke shënuar ‘Për përmirësim’ krahas emërtimit të lëndës. Nëse studentit nuk paraqitet në provim, me vendim të dekanes/nit mbetet nota e vlerësimit të fundit.

2. Në fund të vitit të tretë studentet mund të përmirësojnë deri në tre lënde të gjithë programit të studimit.”
 7. Ndryshimin e nenit 34 “Studenti kalues i një kursi” duke shtuar pikat e mëposhtme:

“3 Në numrin e pikë/krediteve kaluese futen edhe kreditet e moduleve të veçanta.

4. Studentët, që ndjekin ciklin e dytë të studimeve, kalojnë në vitin tjetër pavarësisht nga kreditet e marra.

5. Studentët e vitit të fundit të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve që nuk kanë arritur të diplomohen marrin statusin ‘Studentë jashtë kursit F’C’.”
 8. Ngarkohen dekanët e fakulteteve të USH-së për zbatimin e këtij vendimi.
 9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK



Prof. Dr. Adem BEKTESHI

